



**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMI I KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR TË  
GJIMNAZIT**

**FUSHA : GJUHË SHQIPE – LETËRSI**

**LËNDA : LETËRSI**

**KODI: 4.2.12.Z**

**PROGRAMI I LËNDËS SË LETËRSISË**

**PËR KLASËN E 12<sup>të</sup>**

**TIRANË, PRILL 2010**

Programi i letërsisë, lëndë me zgjedhje, është konceptuar rreth një kornize që përfshin qasje bashkëkohore dhe historike ndaj një leximi që ka në qendër autorin, veprën letrare dhe kontekstin e botës. Nxënës/i-ja mëson që çdo qasje vë theksin tek ndërveprimet që ndodhin midis autorit, veprës, lexuesit dhe kontekstit të botës. Secila qasje përshkruhet me interpretime historike dhe bashkëkohore, por nxënës/i-ja e bazon punën e tij/saj në radhë të parë tek interpretimet bashkëkohore.

## **Përshkrimi i kursit**

### **Pse është i rëndësishëm kursi ?**

*Kursi është i rëndësishëm sepse :*

- synon dhe i mundëson nxënësit të eksplorojnë interesat e tij letrare, të zotërojnë aftësitë e nevojshme për studim (letrar) tërësor të veprës dhe të zhvillojë më tej aftësitë për :
  - të komunikuar, me shkrim dhe me gojë, në mënyrë të saktë, të përshtatshme dhe efektive;
  - të kuptuar dhe reaguuar në mënyrë imagjinare ndaj asaj që dëgjon dhe lexon;
  - të shijuar veprën letrare dhe vlerësuar ndihmesën që ajo jep në rritjen e anës estetike dhe imagjinuese;
- ofron mundësi për punë të larmishme dhe krijuese nga nxënës/i-ja. Gjatë studimit nxënës/i-ja mund të punojë në grupe të vogla, individualisht, në komunikim me mësuesin ose me nxënës të tjerë, në shkollë ose jashtë saj ( si p.sh. me nxënës nga shkolla të tjera përmes e-mail);
- zhvillon më tej elementët e të shkruarit, të folurit dhe elementët e kërkimit që lidhen me standardet kombëtare;
- zhvillon qëndrimin kritik dhe tolerant për gjithçka që lexon;
- zhvillon qëndrimin e pavarur të nxënësit, ndjeshmërinë e tij ndaj vlerave estetike dhe përmbajtjesore të veprave letrare;
- alternon veprimtaritë mësimore të pavarura brenda dhe jashtë procesit mësimor duke iu referuar burimeve .

### **Pse qëndron në fokus kompozimi ?**

Sepse, nëpërmjet punëve me shkrim, nxënës/i-ja:

- kupton dhe çmon procesin krijues duke pasqyruar formimin e tij/saj dhe vlerat e letërsisë;
- familjarizohet me problemet, instrumentet, teknikat dhe format bazë të të shkruarit;
- krijon respekt më të thellë për pushtetin e gjuhës dhe kënaqet me mundësitë e saj;
- zhvillon aftësitë për të vlerësuar objektivisht, rishikuar dhe përmirësuar punimin e tij/saj dhe të të tjerëve.

**Në thelb të procesit mësimor** është të shprehurit me shkrim dhe me gojë i nxënësit bazuar në leximet dhe shkrimet.

Kursi **kombinon studimin** e letërsisë me kompozimin e bazuar në letërsi; **shkrimin** me analizën kritike. Kursi **kërkon** nga nxënës/i-ja shumë lexime dhe shkrime për letërsinë. Marrëdhëniet midis të shkruarit dhe të lexuarit theksohen gjatë gjithë kursit. Duke bërë

një numër të konsiderueshëm punësh me shkrim, nxënës/i-ja do të shprehë estetikisht formimin e tij/saj për letërsinë dhe, nëpërmjet saj mjeshtërinë e të shkruarit.

**Leximet** përfshijnë vepra nga gjinia e prozës, dramës dhe ese, me tematikë sociale, politike, filozofike, psikologjike e historike. **Veprat janë zgjedhur për rëndësinë e tyre historike, për idetë dhe për vlerat estetike.** Të marra së bashku, ato formojnë një tërësi të pasur të shkrimeve imagjinare dhe kritike.

Letërsia, përveç funksionit estetik përcjell mësimë morali, polemika të shumta, interpretime personale. Eksplorimi me kujdes i letërsisë kërkon që ne të sinkronizohemi me qëllimet e saj të ndryshme dhe të detajojmë me aftësi mënyrat e përmbushjes së tyre. Kjo do të thotë që shumë prej diskutimeve në klasë do të përmbajnë komente të veprës për detyrën e dhënë. Në fund të kursit nxënës/i-ja duhet të ketë fituar aftësi për interpretimin e veprës shoqëruar me kuptime të qëndrueshme të konteksteve historike, sociale, psikologjike, filozofike dhe estetike.

Nxënës/i-ja do të lexojë vepra të plota në prozë, minimalisht do të lexojë 8 vepra. Ai/ajo do të analizojë dhe vlerësojë veprën letrare duke ndërevepruar përmes diskutimeve në grup dhe punimeve me shkrim. Autorët dhe veprat letrare që do të lexohen dhe studiohen i përkasin letërsisë shqipe dhe letërsisë botërore.

## 1. Synimi i lëndës

Në përfundim të kursit nxënës/i-ja duhet të jetë i/e aftë:

1. **të eksplorojë** në mënyrë të pavarur natyrën universale të nevojave shpirtërore dhe intelektuale të njeriut dhe shoqërisë njerëzore nëpërmjet letërsisë me fokus dashurinë, drejtësinë, tolerancën, dinjitetin, integritetin etj;
2. **të analizojë dhe të reagojë** ndaj letërsisë duke demonstruar kuptim dhe interpretim të vetëdijshëm;
3. **të shkruajë** në mënyrë kritike dhe krijuese;
4. **të demonstrojë formim të qëndrueshëm** me njohuri për gjuhën dhe letërsinë në nivelin e kërkesave të programit të gjimnazit.

## 2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

### Lidhja e synimeve me objektivat e përgjithshme

Secili nga synimet e mësipërme zërthehet në objektiva të përgjithshme që janë të përbashkëta për të tre vitet e zhvillimit të kësaj lënde në gjimnaz .

Në përfundim të programit të letërsisë nxënës/i-ja :

- **të hulumtojë** informacione, vlerësime dhe qëndrime rreth autorit dhe veprës në tërësi;
- të fitojë **aftësitë e të menduarit kritik**, duke mësuar si t'i përqaset dhe si t'i studiojë këto tekste;

- të parashtojë idetë, qëndrimet e tij/saj për autorin dhe veprën e studiuar dhe të reflektojë sipas sugjerimeve, ideve dhe vlerësimeve që japin të tjerët;
- të aftësohet drejt vlerësimit vetjak të letërsisë;
- të aftësohet për të analizuar veprën letrare duke punuar në mënyrë të pavarur dhe në grupe të vogla;
- të diskutojë dhe të bëjë punë të pavarur rreth ideve, analizave dhe vlerësimeve për veprën;
- të përgatisë dhe të parashtojë me gojë dhe me shkrim punimet e tij/saj përgjithëse për vlerësim në fund të çdo njësie mësimore dhe në fund të kursit.

Për të realizuar synimet e lëndës nëpërmjet objektivave të përgjithshme, nxënës/i-ja duhet:

1. të lexojë me kujdes dhe të analizojë në mënyrë kritike veprat letrare;
2. të kuptojë mënyrën sesi e përdorin gjuhën shkrimtarët për të dhënë kënaqësi estetike dhe domethënie;
3. të kuptojë kompleksitetin e një vepre, të thithë pasurinë e kuptimit dhe të analizojë lidhjet midis kuptimit ( përmbajtjes) dhe formës letrare;
4. të marrë në konsideratë vlerat sociale, historike dhe estetike që reflekton dhe mbart vepra;
5. të marrë në konsideratë strukturën, stilin si dhe përdorimin e gjuhës figurative, imagjinaren, etj;
6. të shkruajë, duke u përqendruar në analizën kritike të letërsisë, ese ekspozuese, analitike, argumentuese dhe interpretuese si dhe shkrime krijuese për të shprehur kuptimin e sipërmarrjes së autorit dhe për të thelluar vlerësimin e aspektit artistik të letërsisë;
7. të zhvillojë më tej aftësitë për kërkim dhe të shkruajë një punim studimor.

### **Kërkesat thelbësore të programit për realizimin e objektivave të përgjithshme**

- Programi parashtron thelbin e analizës në tërësi dhe të elementeve të saj, duke kërkuar që nxënës/i-ja t'i zbatojë njohuritë e fituara në mënyrë të pavarur në detyra formuese si: hulumtim individual ose në grup; parashtrim dhe argumentim i ngjashmërive dhe ndryshimeve; parashtrim dhe argumentim i qëndrimit personal për elementët e analizës.
- Programi kërkon nga nxënës/i-ja të demonstrojë kompetencë për analizën e veprës duke shfrytëzuar shanset e ofruara nga mësuesi si detyra mësimore, fletë pune, kritere e rubrika vlerësimi e vetëvlerësimi, komunikim gojor dhe me shkrim, etj .
- Programi kërkon që nxënës/i-ja të kryejë detyra të pavarura në grup për të parashtruar në klasë, me shkrim ose me gojë, lidhjen midis veprës dhe realitetit.
- Programi ofron mundësi që nxënës/i-ja të zgjedhë tematika ose aspekte, të cilat i thellon duke u bazuar në përshtypjet vetjake ndaj veprës dhe duke u mbështetur nga hulumtimet e kritikës. Mbi bazën e tematikës apo çështjes së përzgjedhur (si p.sh. aspekti i vlerave artistike, vlerat sociale / etike etj) nxënës/i-ja mund të zhvillojë një

punim krahasues me tematikën e zgjedhur; ese argumentuese mbi vlerën e përzgjedhur; pse jo dhe një krijim të mirëfilltë etj.

Kërkesat bazë të programit të lëndës për klasën e 12 organizohen në dy blloqe kryesore formuese: Letërsi dhe Kompozim.

Kërkesat specifike ndaj nxënësit për secilin prej këtyre blloqeve janë :

1. Letërsi	2. Kompozim
<p>Nxënës/i- ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të eksplorojë me vetëdije dhe emocion, nëpërmjet veprave letrare, natyrën, kulturën, identitetin, jetën, përvojën botërore, filozofinë e saj, etj;</li> <li>• të ndjekë një metodologji të caktuar për kërkim;</li> <li>• të thellojë të kuptuarit e mënyrave që përdorin shkrimtarët për ta kthyer gjuhën në përçuese të kënaqësisë estetike dhe të vlerave të tjera përmbajtësore;</li> <li>• të kuptojë dhe analizojë strukturën, stilin, temat e veprës, përdorimin e gjuhës figurative, imagjinatën dhe teknikat e tjera artistike etj;</li> <li>• të kuptojë dhe të analizojë stilet e plotat të të shkruarit, duke lexuar veprat letrare të autorëve të letërsisë shqipe dhe letërsisë botërore;</li> <li>• të zhvillojë të kuptuarit dhe të përgjigjurit në mënyrë imagjinare ndaj asaj që dëgjojnë dhe lexojnë;</li> <li>• të zhvillojë të shijuarit e veprës letrare, vlerësimin e ndihmesës së saj për formimin estetik dhe për rritjen e forcës imagjinuese.</li> </ul>	<p>Nxënës/i-ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të mësojë rreth stilit dhe procesit të kompozimit, duke u fokusuar tek planifikimi, procesi i të shkruarit, redaktimi, rishikimi dhe korrigjimi i punimit;</li> <li>• të zhvillojë komunikim me shkrim dhe me gojë në mënyrë të saktë, të përshtatshme dhe efektive;</li> <li>• të reagojë, korrigjojë, përmirësojë, vetëvlerësojë punimet e tij me shkrim duke krijuar profilin e tij si shkruar;</li> <li>• të aftësohet për të kuptuar dhe çmuar procesin krijues;</li> <li>• të aftësohet të shkruajë në mënyrë kritike dhe krijuese;</li> <li>• të eksplorojë se si gjuha, struktura dhe format e saj kontribuojnë në kuptimin e veprës;</li> <li>• të aftësohet për të kryer veprimtari mësimore të pavarur jashtë procesit mësimor.</li> </ul>
<p><b>Veprimtari të mësimore :</b></p> <p>Duke përdorur një larmi aktivitete ndërevepruese – nga parashtrimet dhe diskutimet në grup tek proceset e të shkruarit - kursi e ndihmon nxënësin të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik , të reagojë bindshëm për atë që lexon.</p> <p>Nëpërmjet diskutimit në grup kursi inkurajon shprehitë e zgjidhjes së problemit dhe të vendimmarrjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyra interpretuese - me shkrim bazuar në letërsi.</li> <li>• Diskutime të gjalla – në grup: për autorin, veprat letrare dhe burimet mbështetëse.</li> <li>• Meditim dhe shkrim kritik.</li> <li>• Shkrimi krijues – nxënësi shkruan pjesë origjinale, i diskuton me shokun, i korrigjojnë dhe përmirësojnë ato sëbashku. Pritet që nxënësi të krijojë profilin e tij</li> </ul>	

ku evidentohet rritja e tij si autorë i ri.

- Dorëshkrime të mundshme për botim.
- Ese të ndryshme bazuar në letërsi.
- Projekte mësimore / kërkimore bazuar në letërsi.
- Hulumtime.
- Një raport me shkrim për një vepër.
- Prezantime gojore.
- Shkrime reaguese ndaj veprës letrare apo letërsisë.

**Vlerësimi i nxënësit :** vlerësimi i nxënësit bëhet në proces dhe në përfundim të tij.

### **Kërkesat thelbësore të mësimdhënies e të nxënies së kursit**

- **Nxënës/i-ja të mësojë nga shkruarit profesionistë.** Për qëllimet tona kjo do të përfshijë analizën e tekstit dhe disa kritika me shkrim për veprat letrare të zgjedhura.
- **Nxënës/i-ja duhet të shkruajë rregullisht.** Këtu përfshihet mbajtja e shënimeve, ushtrimet shpjeguese, plotësimi i një numri esesh me kohë të caktuar, ese formale të zgjeruara, punime hulumtuese dhe një punim kërkimor. Çdo nxënës do të dorëzojë dosjen e punimeve të plotësuara dhe materiale të tjera burimore/ndihmëse në fund të çdo njësie mësimore.
- **Nxënësit duhet t'i ofrohen mundësi** për të shprehur formimin e tij.
- **Nxënësit duhet t'i mundësohet pjesëmarrja** aktive në klasë.
- **Nxënës/i-ja duhet të bashkëpunojë në klasë** dhe jashtë saj për të përmirësuar aftësitë individuale të komunikimit gojor dhe me shkrim. Një pjesë domethënëse e kohës së mësimimit do t'u kushtohet aktiviteteve mësimore ku do të çmohet aftësia për të ofruar kritika objektive dhe konstruktive.
- **Nxënës/i-ja duhet të dokumentojë nivelin e tij/saj** nëpërmjet përzgjedhjes së punimeve.

### **3. OBJEKTIVA TË KURSIT**

#### **KURSI : LETËRSI DHE KOMPOZIM**

**Orë mësimore : 34 orë**

**Struktura e kursit:** Kursi është ndërtuar në tri njësi mësimore.

Diskutimet, punët me shkrim, prezantimet dhe vlerësimet/vetëvlerësimet do të shoqërojnë çdo njësi mësimore të kursit. Në fund të çdo njësie mësimore do të ketë një detyrë kryesore me shkrim, e cila përfshin punimin me bazë kërkimi. Çdo orë mësimore do të ketë punë me shkrim që ndihmon nxënësin të zhvillojë shprehitë e nevojshme dhe të

domosdoshme për parapërgatitjen për shkollën e lartë, për profesionin, për jetën. Udhëzimet gramatikore do të jepen kur është e nevojshme.

### **Tema, përmbajtja dhe struktura e orëve mësimore të njësisë**

Orët mësimore ndërtohen me synimin e përbashkët për të bërë lidhjen e dyanshme midis leximit dhe shkrimit, duke :

- a) zhvilluar dhe perfeksionuar forma dhe qëllime të ndryshme, thelbësore të të shkruarit;
- b) rritur aftësinë për të kuptuar dhe analizuar përmbajtjen e veprave;
- c) nxitur dëshirën dhe motivimin për të lexuar vetë dhe për t’u informuar për letërsinë dhe veprat letrare.

Planifikimi i orëve mësimore është kompetencë e mësuesit. Për planifikimin e orëve mësimore brenda njësisë, për përcaktimin e tematikës me objektivat përkatëse, mësuesi duhet të përpiqet të bëjë zgjedhjen më të mirë për kushtet konkrete të klasës. E rëndësishme është që në të gjitha rastet orët mësimore të përdoren për :

- Zbërthim / diskutim.
- Praktikë shkrimi.
- Korrigjim/ plotësim/ vetëvlerësim.
- Rishkrim paravlerësues.
- Vlerësim.

Mënyra e shpërndarjes së orëve, përmbajtja dhe strukturimi i tyre duhet të mundësojë gjithnjë arritjen e objektivave të njësisë.

### **Njësia mësimore 1**

**Orë të sugjeruara 14 orë**

**Vepra letrare për t’u lexuar: Roman / Ese**

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ismail Kadare , vepra “Kronikë në gur “</li> <li>• Ismail Kadare , vepra “Darka e gabuar “</li> <li>• Ismail Kadare , vepra “E penguara”</li> </ul> <p><i>Ese :</i> “Identiteti evropian i shqiptarëve “</p>
---

<b>Çështjet mësimore</b>	<b>Objektivat mësimorë</b>
<p><b>1. “Letërsia dhe qyteti”</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• raporti që ka shkrimtari me qytetin; qyteti si një qendër zhvillimi, apo si një qendër problematikash sociale; qyteti-personazh.</li> </ul> <p><b>2. Qëndresa e shqiptarëve nëpër shekuj. Këndvështrim i ri i temës historike;</b></p>	<p>Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të demonstrojë lexim të kujdesshëm, kuptim të thellë të veprës letrare si bazë për analizën kritike të saj;</li> <li>• të kuptojë dhe të çmojë se si shkrimtari e përdor gjuhën dhe strukturat e saj për të arritur një efekt</li> </ul>

<p>tingëllimi i mprehtë aktual që i jep asaj.</p> <p>3. Njeriu dhe kërkesa e tij për identitet; pengesat që duhet të kapërcejë gjatë këtij rrugëtimi.</p>	<p>të caktuar në vepër;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të zhvillojë më tej aftësitë për kërkim të pavarur dhe të realizojë një punim mësues studimor;</li> <li>• të gjejë mjetet e ndryshme retorike në veprat letrare dhe t'i përdorë ato në punët e tij me shkrim;</li> <li>• të rishikojë dhe të përmirësojë punimet e tij mbi bazën e kriterëve .</li> </ul>
---	--

### DETYRAT MËSIMORE TË SUGJERUARA

<b>Bloku i formimit letrar</b>	<b>Detyrat mësimore / vlerësime</b>
<p><b>Parashtrim / Analizë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• konteksti i autorit/veprës; vizioni i autorit mbi botën; tematika :specifika e trajtimit të saj në vepër;</li> <li>• subjekti; problematikat;</li> <li>• humori, grotesku,</li> <li>• personazhet:e përbashkëta dhe e veçanta e tyre;</li> <li>• konflikti dhe zgjidhjet e dhëna ;</li> <li>• dimension i artistik: gjuha figurative, stili , forca emocionale, etj.</li> </ul>	<p><b>Diskutime/ parashtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizë e plotë e veprës ( me ilustrime nga vepra, me referenca nga burimet dhe kritika; me argumente personale. Analizohet 1 vepër).</li> <li>• Pjesëmarrje .</li> </ul> <p><b>Punë me shkrim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ese argumentuese formale e zgjeruar: vepra ( 3 faqe) <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi.</li> <li>♣ Diskutim,rishikim,vetëvlerësim</li> </ul> </li> <li>• Ese analitike : vepra <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Rishikim dhe vetëvlerësim</li> </ul> </li> <li>• Ese interpretuese : vepra <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Rishikim dhe vetëvlerësim</li> </ul> </li> <li>• Ese ekspozuese : vepra <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Diskutim, rishikim dhe vetëvlerësim</li> </ul> </li> </ul> <p><b>Punim hulumtues: Artikull</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shkrime mbi krijimtarinë e Kadaresë</li> <li>• artikuj kritikë mbi autorin, veprën etj. <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Diskutim,rishikim,vetëvlerësim.</li> </ul> </li> </ul>
<p><b>Vepra dhe realiteti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duke analizuar rindërtimin e karakterit të një autori.</li> </ul>	<p><b>Diskutim / parashtrim 1</b></p> <p>“Letërsia dhe qyteti”</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporti që ka shkrimtari me qytetin; qyteti si</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personazhe që ngrihen kundër fatit, që përpiqen të kapërcejnë pengesën e shtetit.</li> <li>• Një ngjarje e vërtetë që trazoi një qytet të tërë.</li> <li>• Subjekt i ngjeshur, mendim i thellë shpesh i shprehur me anë të parabolës, mbi bazën e asociacionit apo të analogjive historike.</li> </ul>	<p>një qendër zhvillimi, apo si një qendër problematikash sociale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qyteti-personazh të “Kronikë në gur” Vetëdija qytetare në një vepër të I. Kadaresë.</li> </ul> <p><b>Punë me shkrim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ese interpretuese e zgjeruar -punim në shtëpi. ♣ Rishikim, vetëvlerësim</li> <li>• Ese përshkruese -punim në shtëpi. ♣ Rishikim, vetëvlerësim</li> <li>• Ese jo formale -punim në shtëpi. ♣ Diskutim, rishikim, vetëvlerësim</li> </ul> <p><b>Diskutim / parashtrim 2</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ese “Identiteti evropian i shqiptarëve “</li> </ul> <p><b>Punim hulumtues: Artikull</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Njeriu dhe kërkesa e tij për identitet; pengesat që duhet të kapërcejë gjatë këtij rrugëtimi”.</li> <li>• Nuanca e fjalës në krijimet e Kadaresë -punim në shtëpi. ♣ Diskutim, rishikim, vetëvlerësim.</li> </ul>
<p><b>Vepra dhe unë</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çfarë vlerësoni dhe përse?</li> <li>2. Çfarë do të donit të ishte ndryshe:</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>• në subjekt ?</li> <li>• te personazhet ?</li> <li>• te dialogu?</li> <li>• te stili ?</li> <li>• te gjuha ?</li> <li>• etj.</li> </ul>	<p><b>Punimi bindës /kërkimor (1) ( minimum 5 faqe)</b></p> <p>Punim i pavarur në shtëpi</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kush jam unë dhe cili është vendi im në botë?</li> <li>• Çfarë efektësh ka kultura në identitetin tim ?</li> <li>• Si mund ta arrij unë “ ndriçimin tim” ?</li> <li>• Si ndikojnë rrethanat në zgjedhjet e mia ?</li> <li>• Si i kufizojnë rrethanat zgjedhjet e mija ?</li> <li>• Cilat janë pasojat e përzgjedhjeve të mija?</li> <li>• Çfarë do t’i ndryshoja veprës nëse do ta shkruaja për kontekstin tonë ?</li> </ul> <p><b>Diskutim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutimi i punimit në klasë</li> <li>• Rishikim dhe vetëvlerësim</li> </ul>

### Termet kryesore letrare

Objektivitet, subjektivitet, paralelizëm, perifrazim, rrjedha tragjike, zëri, ironia, protagonist/antagonist, vizioni i autorit mbi botën, pyetje retorike, personazh minorë, suspansë, parabola, asociacioni, analogjia etj.

### Burimet mësimore bazë

- Ismail Kadare: Vepra letrare
- Ismail Kadare: Vepra letrare
- Ismail Kadare: Vepra letrare

### Burimet ndihmëse

- Artikuj kritikë
- Enciklopedi
- Fjalorë të termave letrarë

### Njësia mësimore 2

Orë të sugjeruara 14 orë

Vepra letrare për t'u lexuar: **Roman**

<ul style="list-style-type: none"><li>• Fatos Kongoli : Vepra “Ne të tre “</li><li>• Fatos Kongoli : Vepra “Lëkura e qenit”</li><li>• Fatos Kongoli : Vepra” Jeta në një kuti shkrepësesh “</li><li>• Fatos Kongoli : Vepra “Bolero në vilën e pleqve”</li></ul>
--

Çështjet mësimore	Objektivat mësimorë
<p>Tema sociale në veprat e Fatos Kongolit</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Fati i femrës së pambrojtur.</li><li>• Në kërkim të rrënjëve të skizofrenisë kolektive</li><li>• Jetët e” vogla njerëzore”,dashuritë romantike, tepër të brishta përballë një realiteti plot ligësi.</li><li>• Te jetuarit mes ndjenjës, dashurisë, tradhtisë dhe humanitetit.</li></ul>	<p>Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i-ja :</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• të demonstrojë aplikimin e shprehive të menduarit kritik, në parashtrimet e tij gojore dhe me shkrim, në përgjigje të detyrave dhe kërkesave rreth autorit dhe veprave të tij.</li><li>• të analizojë, nëpërmjet veprave letrare, se si ndërthuren dhe kombinohen në mënyra të ndryshme tek individ, grupet shoqërore dhe shoqëria në tërësi rrethana e faktorë të shumtë si mjedisi, vetmia, sfida, tradita, injoranca, ambicia dhe përgjegjësia, etj, si dhe ndikimin e tyre në zgjedhjet, vendimmarrjet dhe veprimet e tyre me rrjedhojat përkatëse.</li><li>• të eksplorojë dhe të reflektojë në punimet e tij se si gjuha , struktura dhe format kontribuojnë në kuptimin e veprës letrare.</li><li>• të rishikojë dhe të përmirësojë punimet e</li></ul>

**DETYRAT MËSIMORE TË SUGJERUARA**

<b>Bloku i formimit letra</b>	<b>Detyrat mësimore / vlerësime</b>
<p><b>Parashtrim / Analizë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• konteksti i autorit/veprës; vizioni i autorit mbi botën; tematika :specifika e trajtimit të saj në vepër;</li> <li>• subjekti; problematikat;</li> <li>• humori, grotesku,</li> <li>• personazhet:e përbashkëta dhe e veçanta e tyre;</li> <li>• konflikti dhe zgjidhjet e dhëna ;</li> <li>• dimensionimi artistik: gjuha figurative, stili , forca emocionale etj.</li> </ul>	<p><b>Diskutime/ parashtrime</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizë e plotë e veprës ( me ilustrime nga vepra, me referenca nga burimet dhe kritika; me argumente personale. Analizohet 1 vepër).</li> <li>• Pjesëmarrje</li> </ul> <p><b>Punë me shkrim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ese argumentuese formale e zgjeruar: vepra ( 3 faqe) <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Diskutim,rishikim, vetëvlerësim</li> </ul> </li> <li>• Ese analitike : vepra <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Rishikim, vetëvlerësim</li> </ul> </li> <li>• Ese interpretuese: vepra <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Rishikim, vetëvlerësim</li> </ul> </li> <li>• Ese jo formale: vepra <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Diskutim,rishikim, vetëvlerësim</li> </ul> </li> <li>• Ese përshkruese e zgjeruar : “Çfarë i bashkon dhe i largon këto 4 vepra të Kongolit”. <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> <li>♣ Diskutim,rishikim, vetëvlerësim</li> </ul> </li> </ul> <p><b>Punim hulumtues : Artikull</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Ç’është njeriu i dobët ?“ <ul style="list-style-type: none"> <li>- punim në shtëpi</li> <li>♣ Diskutim,rishikim, vetëvlerësim</li> </ul> </li> </ul>
<p><b>Vepra dhe realiteti</b></p> <p>Konflikti midis individit e botës sociale ku jeton.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegoni konfliktin individ shoqëri dhe merrni në konsideratë drejtësinë e vendosjes së individit si</li> </ul>	<p><b>Diskutim / parashtrim 1</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ç’është ndjenja, dashuria, urrejtja, tradhtia dhe humanizmi.</li> </ul> <p><b>Punë me shkrim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ese interpretuese e zgjeruar <ul style="list-style-type: none"> <li>-punim në shtëpi</li> </ul> </li> </ul>

<p>gjykatës i botës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtoni veprat si forma të kritikës sociale. Në secilën vepër evidentoni objektin e kritikës dhe arsyet pse autori e sulmon atë. Merrni në konsideratë edhe mjetin e kritikës – është simpatia e evokuar për viktimat e realiteteve sociale, argumentet e drejtpërdrejta kundër tyre, etj</li> </ul>	<p>♣ Diskutim,rishikim, vetëvlerësim</p> <p><b>Punim hulumtues : Artikull</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Ndjenja dhe ndjeshmëria “</li> <li>• “Konflikti midis individit e botës sociale ku jeton”.</li> </ul> <p>-punim në shtëpi</p> <p>♣ Diskutim,rishikim, vetëvlerësim</p> <p><b>Diskutim / parashtrim 2</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Të bësh një nder, të ndihmosh dikë, pasoje, kaloje nderin”.</li> </ul> <p><b>Punim hulumtues : Artikull</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Shpirti zgjedh shoqërinë e vet “</li> </ul> <p>- punim në shtëpi</p> <p>♣ Diskutim,rishikim, vetëvlerësim</p>
<p><b>Vepra dhe unë</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çfarë vlerësoni dhe përse?</li> <li>2. Çfarë do të donit të ishte ndryshe:</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>• në subjekt ?</li> <li>• te personazhet ?</li> <li>• te dialogu ?</li> <li>• te stili?</li> <li>• te gjuha ?</li> <li>• etj.</li> </ul>	<p><b>Punimi bindës /kërkimor (1)</b> (minimum 5 faqe)</p> <p>Punim i pavarur në shtëpi</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kush jam unë dhe cili është vendi im në botë?</li> <li>• Çfarë efektesh ka kultura në identitetin tim ?</li> <li>• Si mund ta arrij unë “ ndriçimin tim” ?</li> <li>• Si ndikojnë rrethanat në zgjedhjet e mia ?</li> <li>• Si i kufizojnë rrethanat zgjedhjet e mija ?</li> <li>• Cilat janë pasojat e përzgjedhjeve të mija?</li> <li>• Çfarë do t’i ndryshoja veprës nëse do ta shkruaja për kontekstin tonë ?</li> </ul> <p><b>Diskutim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutimi i punimit në klasë</li> <li>• Rishikim dhe vetëvlerësim.</li> </ul>

### Termet kryesore letrare

Motivi, konteksti, metafora e zgjeruar, steriotipi, retorika, subjekti, qëndrimi i autorit, etj.

### Burimet mësimore bazë

- Fatos Kongoli: Vepra letrare
- Fatos Kongoli : Vepra letrare
- Fatos Kongoli : Vepra letrare
- Fatos Kongoli : Vepra letrare

### Burimet ndihmëse

- Artikuj kritikë/ studimorë
- Enciklopedi
- Fjalorë të termave letrarë

### Njësia mësimore 3

Orë të sugjeruara 6 orë

#### Projekti kërkimor i pavarur

Objektiva mësimore
Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i-ja : <ul style="list-style-type: none"><li>• të vlerësojë informacionin dhe të përzgjedhë atë që është e nevojshme për qëllime specifike;</li><li>• të formulojë gjykim të pavarur, bazuar në krahasimin e disa autorëve/veprave të përzgjedhura;</li><li>• të zhvillojë më tej aftësitë për kompozim, ligjërim dhe shprehje të menduarit kritik, përmes studimit të letërsisë;</li><li>• të vlerësojë kompleksitetin e një vepre, të thithë pasurinë e kuptimit dhe të analizojë se si përmbajtja lidhet me formën letrare;</li><li>• të tregojë një vetëdije në rritje kritike dhe tolerance në atë që lexon;</li><li>• të çmojë dhe të vlerësojë letërsinë.</li></ul>

Zgjidhet nga lista e mëposhtme autori dhe jepet për të lexuar një nga veprat e tij. Mësuesi dhe nxënës/i-ja bashkëpunojnë për të përzgjedhur autorin dhe veprën. Nxënësit i kërkohet të bëjnë një punim studimor dhe ta paraqesë atë në klasë. E rëndësishme është që punimi të ketë komponentin e kërkimit të pavarur që i detyron nxënësin të lexojë për sfondin historik, për historinë e letërsisë, për filozofinë, për sociologjinë, estetikën dhe fenë. Nxënës/i-ja duhet të organizojë vetë punën për realizimin e detyrës që nga kërkimi, përzgjedhja dhe përpunimi i informacionit deri tek shkrimi dhe përmirësimi i materialit përfundimtar të projektit . Vepra e përzgjedhur nuk duhet të jetë e trajtuar më parë gjatë viteve shkollore.

Lista e autorëve dhe veprave letrare është rekomanduese. Mësuesi në bashkëpunim me nxënësin, pse jo dhe me prindin, mund të sugjerojë autorë dhe vepra jashtë listës rekomanduese. Sugjerimi, gjithmonë, duhet t'i shërbejë realizimit të objektivave të njësisë mësimore 3 dhe synimeve të kursit.

#### Lista e autorëve/ vepra që do lexohet

Autori	Vepra letrare
1. Suzana Tamaro	<ul style="list-style-type: none"><li>• Dëgjoje zërin tim</li><li>• Jashtë</li><li>• Thuaj zemrës po</li></ul>
2. Isabel Allende	<ul style="list-style-type: none"><li>• Shtëpia e shpirtave</li></ul>

3. Xhejn Osten	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krenari paragjykim</li> </ul>
4. Dan Brown	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diabolus</li> <li>• Mashtrimi i madh</li> <li>• Engjëj dhe djaj</li> <li>• Kodi i Da Vincit</li> </ul>
5. Danielle Steel	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Janë botuar mbi 10 romane, të përzgjidhet një</li> </ul>
6. Kahled Hosseini	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një mijë diej vezullues</li> <li>• Gjuetar i balonave</li> </ul>
7. Imre Kertesz	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Romani i një të pafati</li> </ul>
8. Dino Buzzati	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kolombreja</li> </ul>
9. Mario Vaegus Llosa	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtëpia e gjelbër</li> </ul>
10. Alberto Moravia	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Indiferentët</li> </ul>
11. Gabriel Garsia Markes	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dashuri në kohë të kolerës</li> <li>• Gjethurinat</li> </ul>
12. Oriana Fallaci	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një burrë</li> </ul>
13. Ibsen	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtëpi kuklle</li> </ul>
14. Omar Khajam	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rubairat</li> </ul>
15. Fransuazë Sagan	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mirmëngjes Trishtim</li> </ul>

### **Udhëzime për mësuesin dhe nxënësin :**

- lexoni romanin / dramën;
- përgatisni 8-10 faqe punim kërkimor duke u mbështetur të paktën në 7 burime;
- përgatisni bibliografi me përmbledhje;
- shfrytëzoni dokumentacionin e bibliotekës së shkollës apo qytetit tuaj; Bibliotekës Kombëtare; Bibliotekës së UT; Bibliotekës së QSA; internetin etj;
- përgatisni prezantimin ose krijoni një faqe interneti për klasën.

### Informacioni i kërkuar

- titulli;
- autori, çastet më të rëndësishme të jetës dhe të formimit (biografi e shkurtër);
- gjinia;
- periudha letrare ( përfshihen dhe karakteristikat e përgjithshme dhe specifike të veprave);
- paraqitje e përgjithshme e veprës ( sinops);
- vlerësimi i veprës nga kritika ;
- vlerësimi i veprës nga nxënësi.

Afatet janë sugjeruese, por të domosdoshme; mësuesi në bashkëpunim me nxënësin duhet të bëjë planifikimin e projektit kërkimor të pavarur.

<b>Koha</b>	<b>Hapat e procesit të realizimit të projektit</b>
<b>Shtator/Tetor</b>	Formulimi i temës dhe i pikave kryesore në planifikimin e përbashkët të mësuesit dhe nxënësit
<b>Nëntor</b>	Bibliografia me shpjegime/ me përmbledhje
<b>Dhjetor</b>	Drafti i parë
<b>Janar</b>	Takim i mësuesit me nxënësin për shkrimin dhe rishkrimin
<b>Shkurt</b>	Afati i draftit të përmirësuar
<b>Mars</b>	Takime të mësuesit me nxënësit për shkrimin/ rishkrimin
<b>Prill</b>	Varianti përfundimtar
<b>Maj /qershor</b>	Prezantimet ( vullnetarët e parë, pastaj me short )

### **DETYRAT MËSIMORE TË SUGJERUARA**

<b>Bloku i formimit letrar</b>	<b>Detyrat mësimore / vlerësime</b>
• Diskutim	• përmbledhje e shkurtër e temave/ çështjeve kryesore
• Diskutim	• çfarë ka të përbashkët vepra e zgjedhur me veprat e tjera të këtij autori.
• Diskutim	• lidhur me veprën dhe autorin
• Diskutim	• lidhur me çështjet që ka shtjelluar nxënësi në projekt
• Reflektim	• reflektim mbi projektin
• Vlerësim	• vlerësimi i projektit

#### 4. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Javët e para t'i kushtohen rishikimit të termave letrare dhe elementeve të trillimit. Kjo detyrë do të zhvillohet në mënyrë të pavarur nga nxënës/i-ja nën drejtimin e mësuesit,.

**Në njësinë mësimore 1 dhe 2** nxënës/i-ja do të ndalet në bllokun e formimit letrar: *parashtrim / analiza; vepra dhe realiteti; vepra dhe unë*. Ai/ajo do të kryejë një sërë veprimtarish mësimore si: diskutim, punë me shkrim ( ese, ese formale të zgjeruar, ese jo formale të zgjeruar), punim hulumtues, punim bindës/ kërkimor, etj.

Nxënës/i-ja do të lexojë dhe shkruajë rreth autorit dhe veprës lidhur me bllokun e formimit letrar. Në mënyrë specifike nxënës/i-ja do të diskutojë dhe praktikojë komente mbi veprën, formulim të pyetjeve, dhënie të argumentit, duke përpunuar një tezë efikase dhe duke e mbështetur atë me prova të përshtatshme. Përmes analizës së veprës , nxënës/i-ja do të bëjë përgjithësime për elementët e letërsisë si : tema, vizioni mbi botën, personazhi, figuracioni, stili dhe do t'i mbështesë këto përgjithësime me citime nga teksti dhe burimet mësimore. Nxënës/i-ja, gjithashtu, do të mësojë të vlerësojë burimet mësimore dhe t'i dokumentojë ato në një punim letrar.

Për elementët e veprës letrare ku përfshihen konteksti, vizioni mbi botën, personazhi, ngjarja, konflikti, stili, gjuha artistike, forca emocionale etj, nxënës/i-ja do të bëjë punë me shkrim, ese. Puna me shkrim pasohet me rishikimin, redaktimin nga shoku, korrigjimin nga mësuesi dhe vlerësimin/vetëvlerësimin.

Për autorët dhe veprat e sugjeruara në njësitë mësimore, **nxënës/i-ja do të analizojë një vepër për autor** dhe do të bëjë punë me shkrim për veprat e sugjeruara.

**Tematikat e sugjeruara për punët me shkrim apo diskutimet janë vetëm orientuese.** Mësuesi, në bashkëpunim me nxënësin, mund të përcaktojë tematika dhe çështje të tjera mësimore për autorin dhe veprën letrare. Gjithashtu, mësuesi duhet t'i kërkojë nxënësit që, në punët e tij me shkrim apo në punimin bindës / kërkimor, të përdori metodën krahasuese mes veprash letrare dhe autorësh.

**Punimet me shkrim të nxënësit do të shqyrtohen** për: zgjedhjen efikase të fjalës; strukturën krijuese të fjalisë; përdorimin e gjuhës në funksion të formimit letrar; organizimin e përgjithshëm efikas; qartësinë dhe forcën bindëse të argumentit, ku përfshihet evidenca mbështetëse me citimet. Në punët me shkrim nxënës/i-ja do të praktikojë parimet e të shkruarit, ku përfshihet përdorimi i një larmie strukturash të fjalive.

**Në njësinë mësimore 3** nxënës/i-ja do të zhvillojë një **projekt kërkimor të pavarur**. Jepet lista sugjeruese e autorëve dhe veprave të tyre. Autorët dhe veprat që do të studiohen për projektin kërkimor i përkasin letërsisë botërore. Nxënës/i-ja, vetë ose në bashkëpunim me mësuesin apo me shokët brenda apo jashtë klasës, përcakton se cila do të jetë tematika e punimit studimor. Në varësi të tematikës zgjidhet autori dhe vepra letrare.



Në fillim të vitit shkollor, mësuesi duhet ta njohë nxënësin me kërkesat e realizimit të projektit kërkimor. Mësuesi duhet ta njohë nxënësin me afatet kohore dhe me detyrat konkrete për çdo afat kohor.

Projekti kërkimor mund të realizohet në mënyrë individuale nga nxënës/i-ja ose në grupe të vogla, ku secili anëtar i grupit ka një detyrë të caktuar.

Në mënyrë që nxënës/i-ja të krijojë lidhje të vazhdueshme me letërsinë gjatë gjithë jetës nëpërmjet formimit shkollor, ***i jepet rëndësi qëndrimit të pavarur*** ndaj vlerave estetike dhe përmbajtjesore të veprave letrare. Për këtë qëllim një pjesë e konsiderueshme e detyrave për leximin e veprës, analizën e saj dhe sidomos për reflektimin rreth vlerave që ajo përçon, sugjerohen që të kryen, si veprimtari mësimore të pavarura, jashtë procesit mësimor. Kjo shërben për ta parapërgatitur nxënësin edhe për shkollën e lartë ku puna e pavarur është dominuese.

### **Përshkrimi i aktivitetit të kursit**

Nxënës/i-ja, brenda çdo njësie mësimore, do të zhvillojë punë me shkrim.

**Punimet me shkrim** i japin nxënësit kohë dhe mundësi për të reflektuar ndaj një larmie veprash letrare dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve që lidhen me to.

Nxënës/i-ja do të jetë i përgjegjshëm për të lexuar veprat e sugjeruara për çdo njësi mësimore.

Nxënës/i-ja, për çdo njësi mësimore, do të përgjigjet duke reflektuar rreth veprave / kritikës letrare në punimet e tij/saj me shkrim.

Nxënës/i-ja duhet të zgjedhë burime kritike të besueshme. Të paktën dy artikuj do të jepen si detyrë për tu lexuar, të tjerat do të jenë zgjedhje e nxënësit.

Punët me shkrim do të vlerësohen nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësin në përfundim të çdo njësie.

Nxënës/i-ja, brenda çdo njësie mësimore, do të ketë punë me shkrim, ese, për autorin dhe veprat letrare të sugjeruara në program. Në këto punë mësuesi dhe nxënës/i-ja do të përqendrohen në mënyrat që përdor letërsia për të reflektuar temat universale; ata do të shqyrtojnë dhe diskutojnë gjithashtu për të gjitha elementet që përbëjnë stilin e një autori.

Eseja i jep nxënësit mundësi të shpeshta për vrojtim të kujdesshëm të hollësive formale të tekstit, i zhvillon interpretimin ose shpjegimin e tyre, i zhvillon aftësitë për të kuptuar si janë përdorur në procesin e realizimit të veprës letrare të gjithë përbërësit e saj.

Nxënës/i-ja gjithashtu do të shpjegojë dhe gjykojë vlerësimet e tij/saj. Këto ese inkurajojnë diskutimin në klasë dhe japin mundësi për vetëvlerësim dhe për diskutime midis mësuesit dhe nxënësit.

Nxënës/i-ja rregullisht do të shkruajë një ese ku do t'i kërkohet të shprehet për çështje të caktuara mbi autorin dhe veprat e tij/saj, të ilustruara me detyrën e tij/saj me hollësitë e ndryshme nga vepra, të organizuara idetë e veta dhe të përfundojë punimin me shkrim.

Nxënës/i-ja do të përmirësojë esenë duke përdorur listën e vetëvlerësimit për ta gjykuar punimin e tij/saj në lidhje me përmbajtjen, elementët mbështetës, organizimin, gramatikën, rregullat drejtshkrimore, stilin.

Ndërkohë që nuk do të vlerësohet formalisht çdo përmirësim eseje, nxënës/i-ja do të marrë një “notë” ditore nga shoku për çdo ese dhe përmirësim të saj.

Nxënës/i-ja do të zgjedhë një ese, nga grupi i eseve të dhëna, për të biseduar me mësuesin, për ta rishikuar dhe për ta vlerësuar formalisht duke përdorur rubrikën me pikë.

### **Ese formale e zgjeruar**

Analiza formale e thelluar e mundëson nxënësin të zhvillojë shprehjet e të menduarit kritik vlerësues. Nxënës/i-ja, përmes esesë formale të zgjeruar, do të demonstrojë kuptimin e hollësive të tekstit dhe marrëdhëniet e tyre me kuptimin e përgjithshëm të veprave letrare.

- Nxënës/i-ja do të lexojë veprat letrare të sugjeruara si pjesë e leximeve të verës . Gjatë vitit mësimor nxënës/i-ja do të përcaktojë fokusin e analizës dhe interpretimit të veprave letrare; do të bëjë kërkime për çështje të caktuara dhe do të vlerësojë burimet dhe materialet dytësore që ai/ajo do t'i përdorë për të mbështetur idetë e tij/saj.
- Nxënës/i-ja do të përgatisë një punim ( 3 faqe të shtypura ), duke u mbështetur të paktën në 2 burime. Nxënës/i-ja do të prezantojë punën e tij/saj në klasë. Në realizimin e detyrës bëjnë pjesë: koha e detyrës së dhënë, këshillimi, planifikimi i rishkrimit, materialet shtesë të mbledhura gjatë leximit. Nxënës/i-ja do të shkruajë ese formale të zgjeruar gjatë çdo njësie mësimore.

***Punimi hulumtues / artikuj*** : nxënës/i-ja do të bëjë një punim hulumtues, të mbështetur në dy ose tre artikuj, që kanë të bëjnë me autorin dhe veprën letrare. Ai/ajo mund të trajtojë një çështje tjetër të propozuar nga ai/ajo vetë ose në bashkëpunim me mësuesin. Kjo detyrë mësimore do të realizohet nga nxënës/i-ja në mënyrë të pavarur. Punimi hulumtues do të prezantohet dhe diskutohet në klasë.

Për të realizuar këtë detyrë mësimore të pavarur, nxënës/i-ja mund të punojë individualisht ose në grupe të vogla.

Në fund të njësisë mësimore, për tematikën e sugjeruar nxënës/i-ja do të shkruajë ***një punim bindës / kërkimor, minimum prej 5 faqesh.***

Në këtë ***punim bindës / kërkimor*** nxënës/i-ja do të kërkojë dhe mbrojë pikëpamjen e tij/saj për çështje sociale bashkëkohore. Përgatitja e punimit kërkimor duhet të mbështetet të paktën në 3 burime, të shtypura dhe elektronike. Punimi duhet të përmbajë një faqe citim nga vepra. Punimi duhet të jetë minimalisht 5 faqe të shtypura, ku nxënës/i-ja të mbrojë pikëpamjen e tij/saj për çështjen që ka zgjedhur. Punimi përfundimtar duhet të përmbajë dy rishikime, të cilat mësuesi i ka lexuar dhe miratuar, një përmbledhje dhe evidencën e kërkimit të tij/saj (skedat ose kopja e kërkimit). Në punimin kërkimor nxënës/i-ja do të gjejë për hollësitë, organizimin, përdorimin e duhur të kalimeve nga paragrafi në paragraf dhe koherencën e përgjithshme të punimit. Punimi bindës / kërkimor do të prezantohet dhe diskutohet në klasë. Për të realizuar këtë detyrë mësimore të pavarur, nxënës/i-ja mund të punojë individualisht ose në grupe të vogla. Çdo anëtar i grupit, në punimin bindës / kërkimor, ka një detyrë të caktuar. Kjo detyrë mësimore do të realizohet nga nxënës/i-ja në mënyrë të pavarur, jashtë procesit mësimor.

***Korrigjimi i punëve me shkrim.*** Punët me shkrim “korrigjohen “ nga nxënës/i-ja dhe shkëmbehet me shokun brenda orës mësimore. Në përfundim të orës, mësuesi i mbledh punët me shkrim, i shikon dhe bën vlerësimin me fjalë, se çfarë ka arritur nxënës/i-ja në bazë të synimeve që ka pasur puna me shkrim. Tërësia e punëve me shkrim çon në vlerësimin me notë të tyre. Gjithashtu, nxënës/i-ja ka të drejtë të zgjedhë një ese, nga grupi i eseve të dhëna, për të biseduar me mësuesin, për ta rishikuar dhe për ta vlerësuar formalisht.

Pas përfundimit të grup punëve me shkrim, bëhet diskutimi i tyre në klasë.

Të gjitha punët me shkrim kanë orë të planifikuara për rishikim dhe vetëvlerësim.

### **Diskutimi dhe pjesëmarrja aktive në klasë**

Diskutimi aktiv dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e klasës janë thelbësore për nxënësin për të kuptuar veprat letrare dhe për të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik.

- Nxënës/i-ja duhet të marrë pjesë rregullisht në diskutime.
- Nxënës/i-ja duhet të japi një kontribut pozitiv në diskutim, ndërsa ruan një atmosferë në të cilën pyetjet dhe debati i gjallë janë inkurajues dhe të pritura.

### **Detyrat për lexim gjatë verës**

Veprat e rekomanduara në program për realizimin e njësive mësimore do të lexohen gjatë verës. Për secilën vepër të lexuar nxënës/i-ja do të përgatisë një përmbledhje, minimalisht një faqe. Kjo detyrë do të futet në dosjen e nxënësit në fillim të vitit shkollor. Përgatitja, aktivizimi dhe realizimi i detyrave për çdo njësi mësimore lidhen me detyrën e realizuar gjatë verës. Kjo detyrë do të merret në konsideratë në vlerësimin përmbledhës të dosjes së nxënësit.

Autori dhe vepra që do të jenë objekt i projektit kërkimor të pavarur caktohen në fillim të vitit shkollor.

Gjatë punës së tij mësuesi duhet ta orientojë nxënësin që të ndjekë këtë rregull : **“Mos hidh asgjë që ke shkruar. Rishikimi i tyre ka vlerë pasi i jep jetë një ideje apo punimi të ardhshëm”**.

Mësuesi duhet ta këshillojë nxënësin për 2 mjete kryesore - *portofoli i nxënësit dhe blloku i shënimeve* :

### 1. Portofoli i nxënësit ose Dosja e punimeve :

- përdorni dosjen për të mbajtur në një vend çdo gjë që ju shkruani, përfshi dorëshkrimet në klasë dhe jashtë saj, draftet , shënimet, punimet etj;
- periodikisht ju duhet të shikoni dosjen dhe të përpiqeni të zhvilloni më tej disa prej shënimeve. Shpesh një ide që duket krejt e vdekur në fillim të vitit, pulson duke marrë jetë në fund të semestrit;
- fragmentet/ paragrafët që janë dukur të palidhura mundet, që, me kontrollin e mëvonshëm, të lidhen në imagjinatën tuaj;
- një draft i lënë mënjanë mundet, me një ide, befas të marrë udhë drejt një shkrimi të përfunduar. Kështu punimet transformohen gradualisht deri në variantin përfundimtar.

### 2. Blloku i shënimeve

Çdo nxënës duhet të ketë një bllok shënimesh, që mbahet me vete. Regjistrimi i asaj që shikon dhe dëgjon, imazhe të zakonshme dhe befasuese, pjesë bisede, përshtypje, gjithçka që bie në sy, ose që mendohet është zakoni i parë i shkruarit. Nuk ka rëndësi sesa krijon imagjinata juaj, ju keni nevojë për lëndë të parë për të ndërtuar. Nuk ka rëndësi se sa e fortë është kujtesa juaj, pjesa dërmuese e asaj që vrojtoni, mendoni dhe ndjeni do të humbasë. Blloku i shënimeve tuaja ju ndihmon që të ruani këto copëza të jetës aktuale që janë qeliza dhe gjaku i jetës së punimeve tuaja, si shkruar. Akti i regjistrimit mund të forcojë aftësinë tuaj për të vrojtuar dhe ju ndihmon të bëheni “ një nga ata njerëz të cilëve nuk ju shpëton asgjë “ .

## 5. VLERËSIMI

Vlerësimi duhet të konsiderohet si një **mjet diagnostikimi dhe përmirësimi i performancës së nxënësit gjatë procesit të nxënies** dhe, në **përfundim të tij, si mjet për të demonstruar arritjen** e objektivave.

Vlerësimi në këtë kurs është i bazuar në kritere, përmbushja e të cilave tregon nivelin e arritjes së objektivave, duke minimizuar karakterin subjektiv të vlerësimit.

*Nisur nga natyra e lëndës, kompleksiteti i proceseve të të menduarit, të domosdoshme për t'iu përgjigjur detyrave të vlerësimit, veprimtaritë e nxënies të ofruara nga mësuesi duhet të jenë të larmishme, të përshkallëzuara dhe të mirëbalancuara, me shkrim dhe me gojë, për të mundësuar vlerësimin e progresit të çdo nxënësi në lidhje me objektivat mësimori dhe nivelin e arritjes së tyre.*

## **Vlerësimi me notë gjatë procesit të nxënies dhe në përfundim të tij.**

Synimi i përgjithshëm i kursit është që nxënës/i-ja të zhvillojë dhe të demonstrojë, nëpërmjet lëndës, aftësitë e tij/saj për të shprehur qartë e bindshëm idetë e qëndrimet edhe si shkruar i mirë.

*Që të zhvillohet si një shkruar i mirë, në përputhje me aftësitë e interesat, pse jo edhe si krijues nxënës/i-ja, duhet :*

- **Të shkruajë rregullisht.** Praktikimi i të shkruarit përfshin shkrime të shpeshta përshkruese si detyra mësimore ose jo mësimore si nevoja e shtypa individuale, të cilat i rishikon dhe i përsos vazhdimisht .
- **Të lexojë sistematikisht.** Leximi i veprës letrare është kyç jo vetëm për përvetësimin e teknikave të mjeshtërisë të të shkruarit, por edhe për të qenë aktiv në diskutimet rreth letërsisë, tematikave, përmbajtjeve dhe vlerave që ajo përçon tek lexuesi.
- **Të mësojë të pranojë sugjerime e kritika,** të reflektojë ndaj tyre dhe t'u parashtrijë të tjerëve sugjerimet e kritikave të tij. Pranimi i kritikës dhe reagimi pozitiv ndaj saj është një shprehje e çmuar që duhet zhvilluar. Nxënës/i-ja që ka mësuar të pranojë kritikave të dobishme përmirësohet më shpejt.
- **Të vetëpërmirësohet vijueshmërisht.** Nxënës/i-ja duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta përmirësuar vazhdimisht mënyrën e të shkruarit.

Punimet e nxënësit duhet të pësojnë përmirësime të vazhdueshme derisa vetë ai të përzgjedhë variantin më të arrirë në dosjen e punimeve për t'u vlerësuar me notë nga mësuesi, i cili merr parasysh edhe evoluimin e shkrimit.

Gjatë zhvillimit të kursit, në çdo njësi mësimore, nxënës/i-ja do të kryejë një numër të konsiderueshëm dhe të larmishëm punësh me shkrim, si :

- ese formale e zgjeruar;
- ese interpretuese e zgjeruar;
- ese analitike/argumentuese/eksponuese/ jo formale;
- punim hulumtues;
- punim bindës /kërkimor etj.

Nxënës/i-ja, në realizimin e punëve me shkrim, do të mbështetet në veprat letrare të lexuara, në burimet alternative dhe në diskutimet në klasë.

## **Vlerësimi për çdo njësi mësimore**

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet si në proces, ashtu dhe në përfundim të njësisë mësimore. *Të dyja format e vlerësimit janë të lidhura me njëra tjetrën dhe sëbashku kontribuojnë në vlerësimin përfundimtar të nxënësit, në çdo njësi mësimore.*

Të dyja format e vlerësimit u referohen kritereve të përcaktuara me të cilat njihet paraprakisht edhe vetë nxënës/i-ja.

**Vlerësimi** i nxënësit në proces dhe në përfundim të njësisë mësimore **do të bëhet** kryesisht nëpërmjet :

- një eseje formale të zgjeruar;
- një punimi hulumtues;
- një eseje interpretuese të zgjeruar;
- një punimi bindës/ kërkimor;
- diskutimit, pyetjeve të shtruara dhe përgjigjeve të dhëna.

Vlerësimi i nxënësit, për secilën nga punimet e mësipërme, duhet të evidentojë progresin, procesin aftësues të tij për atë lloj shkrimi që kulmon me punimin më të mirë të realizuar brenda njësisë mësimore. Nxënës/i-ja nuk do të vlerësohet me notë pas çdo eseje, pasi aftësimi i tij/saj është një proces . Në përfundim të procesit të shkrimit të grup – eseve, në bazë të pikëve që nxënës/i-ja ka marrë për çdo ese, bëhet vlerësimi i progresit të nxënësit. Mësuesi do të ndjekë ecurinë e realizimit të tyre hap pas hapi, brenda çdo njësie mësimore, duke u kushtuar vëmendje përmirësimit dhe progresit të nxënësit nëpërmjet rishikimit, korrigjimit dhe redaktimit të tyre. Pas çdo punimi eseje, mësuesi koordinon vlerësimin e tij me vetëvlerësimin dhe me vlerësimin e bërë nga nxënësit e tjerë.

**Nota për çdo njësi mësimore** do të jetë përfaqësuese e notave të marra për secilën nga punimet e mësipërme. Nota për çdo punim do të bazohet në pikët e marra nga korrigjimi i detyrës bazuar në rubrikën përkatëse, të cilën mësuesi ua bën të njohur paraprakisht nxënësve ose e ndërton bashkë me ta.

	<b>Forma të vlerësimit</b>	
	<b>Gjatë zhvillimit të njësisë</b>	<b>Në përfundim të njësisë</b>
Fokusi i vlerësimit	Aftësimi për secilin prej kritereve të detyrës vlerësuese.	Vlerësimi me pikë sipas kritereve të rubrikës.
Kriteret e vlerësimit	Mësuesi i përcakton (i specifikon më tej nëse u referohet rubrikave të sugjeruara), i diskuton dhe i miraton bashkë me nxënësin.	Përzgjedh dhe kombinon kriteret më përfaqësuese të formimit dhe ndërton rubrikën për vlerësimin e detyrës së dhënë.
Detyrat për vlerësim	Të larmishme dhe të përshkallëzuar në tri nivele vështirësie.	Koncepton detyrën vlerësuese që e mundëson nxënësin të demonstrojë arritjen e tij ndaj objektivave të njësisë.
Notat sipas pikëve për secilin nga kriteret e rubrikës përkatëse	Aftësim i nxënësit për të gjykuar objektivisht, bazuar në kriteret, për detyrat e veta dhe të shokëve, të zhvilluara gjatë njësisë.	Nota e bazuar në pikët e marra për secilin nga kriteret e detyrës orienton qartë nxënësin për arritjet dhe mundësitë e tij .

## Rubrikat e vlerësimit të nxënësit në përfundim të çdo njësie mësimore

Për secilën nga detyrat aftësuese dhe vlerësuese me notë në përfundim të çdo njësie, mësuesi dhe nxënës/i-ja mbështeten në rubrikat e vlerësimit që përbëhen nga kriteret bazë për të gjykuar objektivisht për progresin dhe mundësitë për aftësim të mëtejshëm. Në këtë kontekst, merr rëndësi të veçantë ndërtimi i rubrikave për secilën prej detyrave të përzgjedhura për vlerësim. Më poshtë po japim disa modele rubrikash për secilën nga detyrat e përcaktuara të domosdoshme për të vlerësuar progresin e nxënësit gjatë zhvillimit të njësisë mësimore dhe vlerësimin e tij me notë në përfundim të saj. Kriteret përbërëse të rubrikave mund të përshtaten, të detajohen në kriteret më specifike ose më të përgjithshme. Ato dhe mund të rikonceptohen nga mësuesi. E rëndësishme është që nxënës/i-ja të informohet paraprakisht në fillimin e çdo njësie mësimore me kriteret e vlerësimit të përcaktuara nga mësuesi, të cilat duhet të kuptohen dhe të miratohen edhe nga nxënës/i-ja.

### RUBRIKË VLERËSIMI : DISKUTIMI NË GRUP ( shembull)

KRITERE VLERËSIMI	NIVELET E PRITSHME TË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE				Pikët
	Niveli : Fillestar	Niveli : Mesatar	Niveli : i arrirë	Niveli : i avancuar	
Idetë e parashtruara për tematikën e dhënë .	4	6	8	10	<b>10</b>
Mbështetja e idesë me hollësi, shembuj dhe argumente.	2	6	10	15	<b>15</b>
Respektimi i rregullave të diskutimit ( dëgjimi, komunikimi jo verbal me sy, gjeste, mimikë, tonin e zërit ).	2	3	4	5	<b>5</b>
Bashkëpunimi në grup: Pjesëmarrja dhe reagimi në momentin dhe mënyrën e duhur.	1	2	3	4	<b>5</b>
Pjesëmarrja aktive : shprehja e mendimeve, ndjenjave , ideve të veta për t'i kuptuar të tjerët.	1	2	3	4	<b>5</b>
Evoluimi i mendimit dhe i qëndrimit individual: <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerësimi i mendimeve të të tjerëve;</li> <li>• pasurimi argumenteve vetjakë;</li> <li>• ndryshimi i mendimit/ pozicionit fillestar.</li> </ul>	2	4	8	10	<b>10</b>

### RUBRIKË VLERËSIMI: ESEJA ( shembull)

KRITERE VLERËSIMI	NIVELET E PRITSHME TË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE				Pikët
	Niveli : Fillestar	Niveli : Mesatar	Niveli : i arrirë	Niveli : i avancuar	
Idetë e parashtruara, organizimi i tyre.	4	6	8	10	<b>10</b>
Mbështetja ideve kryesore me hollësi dhe shembuj.	4	6	8	10	<b>10</b>
Shumëllojshmëria e fjalive, gjuha e përdorur.	4	6	8	10	<b>10</b>
Saktësia gjuhësore.	4	6	8	10	<b>10</b>
Struktura e punimit - koherenca e saj.	4	6	8	10	<b>10</b>

### RUBRIKË VLERËSIMI : KËRKIMI

Raportimet me gojë dhe me shkrim, të bazuara në kërkimin e informacionit , të fakteve,  
dhe ideve në lëndën e letërsisë, karakterizohen nga këto kritere :

KRITERE	Niveli 1: fillestar	Niveli 2: Mesatar	Niveli 3: i arrirë	Niveli 4: avancuar	Pikët
Zotëron dhe përdor teknikat bazë të kërkimit , evidentimit dhe shfrytëzimit të burimeve të informacionit.	2	4	6	8	<b>10</b>
Përfshin informacion nga të gjitha perspektivat e rëndësishme duke marrë parasysh vlefshmërinë dhe besueshmërinë e burimeve.	2	4	6	8	<b>10</b>
Citon dhe i referohet tërësisë së burimeve të shfrytëzuara.	2	4	6	8	<b>10</b>
Paraqit dhe argumenton duke u bazuar në disa burime në mbështetje të tezës kryesore.	2	4	6	8	<b>10</b>
Shpjegon arsyet e veta për ngjashmëritë dhe dallimet në burimet parësore dhe dytësore për të mbështetur ose pasuruar parashtrimin e tij gojor ose me shkrim.	2	4	6	8	<b>10</b>



## RUBRIKË VLERËSIMI : SHKRIMI BINDËS

KRITERE	Niveli 1: Fillestar	Niveli 2: Mesatar	Niveli 3: i arrirë	Niveli 4: avancuar	Pikët
Strukturimi i ideve dhe i argumenteve në mënyrë logjike dhe të qëndrueshme.	2	4	6	8	<b>10</b>
Përdorimi i mjeteve specifike për të mbështetur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• pohimet logjike përmes arsytimit;</li> <li>• fjalitë emocionuese ose bindjet etike;</li> <li>• ngjarjet personale, rastet konkrete ose analogjitë.</li> </ul>	2	4	6	8	<b>10</b>
Qartësimi dhe mbrojtja e pozicioneve me evidencë të qartë dhe të vlefshme duke përfshirë : <ul style="list-style-type: none"> <li>• fakte, opinione eksperti;</li> <li>• citime dhe shprehje bindjesh të pranuar në masë;</li> <li>• arsytime logjike.</li> </ul>	2	4	6	8	<b>10</b>
Adresim i problematikave, kundërshtive, paragjytimeve.	2	4	6	8	<b>10</b>
Saktësia gjuhësore e punimit.	2	4	6	8	<b>10</b>

Gjatë procesit të nxënies *merr rëndësi aftësimi i nxënësit për të gjykuar vetë për progresin* dhe arritjen ose mosarritjen e objektivit mësimor. Në vlerësimin përmbljedhës, mësuesi dhe nxënës/i-ja gjykojnë dhe bien dakord për notën që konverton pikët e marra nga korrigjimi i detyrës, bazuar në rubrikën përkatëse.

### Konvertimi i pikëve në notë

Pikët e marra pas korrigjimit të detyrës (nga mësuesi, vetë nxënës/i-ja apo shokët e tij ), sipas rubrikës përkatëse për vlerësim, konvertohen në notë sipas kësaj tablele :

PIKËT	NOTA
<b>0-5</b>	<b>4</b>
<b>6-10</b>	<b>5</b>
11-20	6
21-30	7
31-40	8
<b>41-45</b>	<b>9</b>
<b>46-50</b>	<b>10</b>

Vlerësimi i detyrës duke konvertuar pikët e marra në notë ka domethënie konkrete për mësuesin dhe për nxënësin, pasi i orienton ata konkretisht se për cilin prej kriterëve të rubrikës së detyrës janë marrë pikët maksimale apo minimale dhe çfarë duhet bërë më tej për të përmirësuar rezultatin. Vlerësimi i detyrës sipas kriterëve të rubrikës duhet praktikuar si gjatë vlerësimit aftësues, ashtu dhe në përfundim të procesit të nxënies, pasi ndihmon për të orientuar mësuesin dhe nxënësin se ku duhen fokusuar përpjekjet për tu aftësuar më tej në zotërimin e mjeshtërisë të të shkruarit. Vlerësimi me pikë, sipas kriterëve të rubrikës për secilën prej grupit të detyrave të domosdoshme, për të gjykuar për progresin dhe arritjet e nxënësit në përfundim të çdo njësie mësimore, jo vetëm unifikon dhe objektivizon vlerësimin e nxënësit nga mësuesi, por dhe aftëson nxënësin për të bërë vetëvlerësimin. Është e rëndësishme që nxënës/i-ja të aftësohet dhe të demonstrojë se është në gjendje të vlerësojë objektivisht detyrat e tij/saj dhe të shokëve, duke u mbështetur në rubrikat dhe pikët për secilin nga kriteret e tyre përbërëse. Kjo arritje përbën një tregues të rëndësishëm të formimit të nxënësit .

### **Vlerësimi përmbledhës, vjetor i nxënësit**

Vlerësimi i nxënësit përbëhet nga dy komponentë :

1. Vlerësim gjatë procesit të nxënies ( për të evidentuar progresin e nxënësit drejt objektivave mësimore ose standardit lëndor );
2. Vlerësim i arritjes së nxënësit.

Nota vjetore përfaqëson punën dhe arritjet e nxënësit gjatë gjithë vitit shkollor duke shprehur suksesin më të madh të tij nëpërmjet punimeve individuale. Nota vjetore përbëhet nga dy komponentë:**a)** Vlerësimi përmbledhës,përfaqësues i arritjeve të nxënësit gjatë njësie mësimore ( gjithsej 80 % ); **b)** Vlerësimi për projektin mësimor ( gjithsej 20 % ).

#### **a) Vlerësimi vjetor duke ju referuar njësie mësimore**

Vlerësimi vjetor duke ju referuar njësie mësimore do të bëhet në dy mënyra :

- Nxënës/i-ja përzgjedh katër punimet më të mira nga të dyja njësitë mësimore mbi bazën e të cilave mësuesi përcakton notën përfaqësuese vjetore.
- Mësuesi nxjerr notën vjetore si mesataren e notave më të mira të realizuara gjatë vitit nga nxënës/i-ja për secilin prej punimeve të kërkuara për vlerësim me notë, njësi pas njësie mësimore.

**Nota përmbledhëse e të gjitha njësive** do të jetë notë mesatare e notave më të larta të marra gjatë njësive për atë punim vlerësues.

Punimet për vlerësim	Vlerësimet me notë për çdo punim brenda njësisë		Nota përmbledhëse e njësive mësimore
	Njësia: 1	Njësia: 2	
Një ese formale të zgjeruar			Maksimalja për esenë formale
Një punim hulumtues			Maksimalja për punimin hulumtues
Një ese interpretuese e zgjeruar			Maksimalja për esenë interpretuese
Një punim bindës/ kërkimor			Maksimalja për punimin bindës / kërkimor
Diskutimet, pyetjet e shtruara dhe përgjigjet e dhëna			Maksimalja për rubrikën e diskutimeve, pyetjeve dhe përgjigjeve
<b>Nota vjetore si mesatare e notave maksimale të marra për çdo punim vlerësues :</b>			

#### **b) Vlerësimi i projektit mësimor, pesha e tij në vlerësimin vjetor.**

Nota përmbledhëse sipas njësive mësimore përfaqëson 80 % të notës përfundimtare vjetore. 20 % i vlerësimit përfundimtar vjetor lidhet me projektin mësimor ( njësia 3 ), të cilin, kur e realizon individualisht, nxënës/i-ja merr maksimumin 20 %, kurse kur e zhvillon në grup mund të marrë maksimalisht 10 % .

**Në përfundim të kursit nxënësi vlerësohet mbi bazën e dosjes së punimeve.** Dosja e punimeve të nxënësit do të përmbajë të gjitha punimet që ai ka bërë gjatë çdo njësie mësimore, por vlerësimi përfundimtar (vjetor ) bëhet për :

- esenë formale të zgjeruar më të mirë;
- esenë interpretuese të zgjeruar më të mirë;
- punimin hulumtues më të mirë;
- shkrimin bindës /kritik më të mirë;
- projektin e pavarur kërkimor;
- arritjen më të mirë në diskutimet, pyetjet dhe përgjigjet.

## FORMATI PËR VLERËSIMIN PERMBLEDHES VJETOR TË NXËNËSIT

N X E N E S I : (Emri mbiemri )	Njësia 1					Njësia 2					Njësia 3		Vjetore
	Një ese formale e zgjeruar	Një punim hulumtues	Një ese interpretuese e zgjeruar	Një punim bindës/ kërkimor	Diskutime	Një ese formale e zgjeruar	Një punim hulumtues	Një ese interpretuese e zgjeruar	Një punim bindës/ kërkimor	Diskutime	Projekt/ krijim individual	Projekt në grup	NOTA ME SHPJEGIMET PERKATESE
Nota e njësisë					Nota e njësisë					Nota e njësisë ( 20 % )			
Nota e punimeve të përzgjedhura nga nxënësi					Nota e diskutimeve								
NOTA PERMBLEDHESE E NJESIVE ( 80 % ) SIPAS DY ALTERNATIVAVE TE MESIPERME													

### Shënim :

- Vlerësimet e njësive mësimore do të bazohen në rubrikat përkatëse .
- Pësha e vlerësimit të çdo punimi në notën përfaqësuese të njësisë mësimore do të përcaktohet nga mësuesi.
- Të dyja njësitë kanë peshë të barabartë në notën përmbledhëse të njësive mësimore .
- Në rastin kur nxënës/i-ja zgjedh vetë punimet me të cilat do të vlerësohet në përfundim të njësive mësimore, mësuesi mund të kombinojë vlerësimin e tij për diskutimin me vetëvlerësimin dhe vlerësimin e diskutimit sipas rubrikës nga shokët.